



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



KPM-2018/01

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE

Në mbështetje të nenit 15.10 të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve (Ligjit për KPM-në), me qëllim të përcaktimit të rregullave të organizimit, procedurave të punës dhe të funksionimit të KPM-së, në mbledhjen e vet të mbajtur me datën 18 shtator 2018, miratoi:

RREGULLOREN E PUNËS SË KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MEDIA

Neni 1

Dispozitat e përgjithshme

Rregullorja e Punës së Komisionit të Pavarur për Media (tani e tutje “KPM”) është akt i brendshëm i cili përcakton mënyrën e përmbushjes së funksioneve dhe funksionimit të KPM-së dhe detyrat e Zyrës Ekzekutive të KMP-së ndaj KPM-së dhe atë: Konstituimin e KPM-së, thirrjen e mbledhjeve të KPM-së, kuorumin për punë dhe vendimmarrje të KPM-së, mbajtjen e mbledhjeve të KPM-së, procedurat e marrjes së vendimeve, transparencën e punës së KPM-së, konfliktin e interesave, gjuhët që do të përdoren në punën e KPM-së, përgatitjen e mbledhjeve të KPM-së, rregullimin e marrjes së shënimeve (procesverbaleve) të KPM-së, themelimin e grupeve punuese të KPM-së si dhe çështje tjera me interes për punën dhe mbarëvajtjen e KPM-së.

Neni 2

Konstituimi i KPM-së

KPM-ja konsiderohet e konstituuar nëse ka të emëruar nga themeluesi (Kuvendi i Kosovës) së paku 2/3 e të gjithë anëtarëve të KPM-së dhe ka të zgjedhur Kryetarin dhe Nënkryetarin e KPM-së.

Neni 3

Zgjedhja e Kryetarit dhe Nënkryetarit të KPM-së

1. Zgjedhja e Kryetarit dhe/ose Nënkryetarit bëhet në mbledhjen e parë pas mungesës së tyre (përfundim të mandatit, shkarkimit, ose ndonjë arsyeje tjetër të pamundësisë së ushtrimit të funksionit të Kryetarit dhe/ose Nënkryetarit) me shumicë të thjeshtë votash, nga radhët e anëtarëve të KPM-së, nëse në mbledhje janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të KPM-së.
2. Votimi për zgjedhjen e Kryetarit dhe/ose Nënkryetarit të KPM-së, bëhet me vota të fshehta. Jo më shumë se dy (2) herë, anëtarët e KPM-së, mund të propozojnë dhe votojnë kandidatin e njëjtë për Kryetar dhe Nënkryetar të KPM-së.

Neni 4

Thirrja e mbledhjeve të KPM-së

Kryetari i KPM-së, të paktën një herë në muaj thërret mbledhjet e rregullta të KPM-së. Mbledhjet e KPM-së mund të caktohen dhe të thirren nga Kryetari apo me kërkesën e së paku katër (4) anëtarëve të KPM-së.

Neni 5

Përgatitja e mbledhjeve të KPM-së

1. Zyra e Ekzekutive e KPM-së, nën udhëheqjen e Kryeshefit Ekzekutiv, është përgjegjëse për përgatitjet teknike të mbledhjeve të KPM-së. Kryeshefi Ekzekutiv do të caktoj një anëtar të personelit të Zyrës Ekzekutive që të ketë përgjegjësinë kryesore për përgatitjen e mbledhjeve të KPM-së dhe për këtë person do ta njoftoj KPM-në. Kryeshefi Ekzekutiv është përgjegjës për mbarëvajtjen e procedurës dhe orarit për përgatitjen e mbledhjeve të KPM-së që iu mundëson anëtarëve të KPM-së të pranojnë rendin e ditës së bashku me materialet për mbledhjet e rregullta 3 ditë më herët, ndërsa në rastin e mbledhjeve të jashtëzakonshme materialet përcjellën bashkë me arsyen e konvokimit të mbledhjes.
2. Kryeshefi Ekzekutiv i KPM-së dhe personeli tjetër të cilin ai/ajo e përcakton do të jetë prezent në mbledhjet e KPM-së. KPM-ja mundë të vendosë kohë pas kohe se deri në çfarë mase personeli tjetër do të jenë të pranishëm në mbledhjet të KPM-së.
3. Kryeshefi Ekzekutiv është përgjegjës për përgatitjen e rasteve për mbledhjen e KPM-së, përfshirë rastet e licencimit, rastet e shkeljes së kushteve të licencës dhe çfarëdo lloji tjetër të rasteve sipas ligjit të KPM-së apo ndonjë ligji tjetër të aplikueshëm. Kryeshefi Ekzekutiv u delegon drejtorëve të Departamenteve gjegjëse të Zyrës Ekzekutive detyrat dhe përgjegjësitë për përgatitjet e rasteve të caktuara (ligjore, të licencimit, menaxhimit frekuencor, të monitorimit dhe analizës së mediave dhe të administratës) me rekomandime.
4. KPM-ja do të lëshoj udhëzime për atë se kur janë të nevojshme seancat dëgjimore me palët e përfshira për rastet e ndryshme. Kryeshefi Ekzekutiv do të aranzhoj seancat dëgjimore në pajtueshmëri me këto udhëzime.
5. Kryeshefi Ekzekutiv dhe personeli i Zyrës Ekzekutive do t'i ofrojnë përkrahje profesionale anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Mediave në lidhje me kryerjen e obligimeve që dalin nga Ligji për KPM-në. Ndihma profesionale duhet të ofrohet qoftë përmes këshillave me shkrim apo gojë për një çështje të caktuar, qoftë përmes pjesëmarrjes në takime brenda dhe jashtë institucionit.

Neni 6

Kuorumi i mbledhjeve të KPM-së

1. Asnjë mbledhje e KPM-së nuk do të filloj ose vazhdojë pa KPM-në e konstituuar dhe pa sigurimin e kuorumi të domosdoshëm për mbajtjen e mbledhjes.
2. Kuorumi ekziston nëse në mbledhje janë të pranishëm së paku katër (4) anëtar të KPM-së përfshirë edhe Kryetarin.
3. Kryeshefi Ekzekutiv merr pjesë në të gjitha mbledhjet e KPM-së pa të drejtë vote.

